




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
Nr. 1139
Biv./stranica 02
Nr. pages 02

Nr. Prot. 01-1780/15
Br. Prot. 01-1780/15
Prot. No. 01-1780/15
Date 01-07-2015
Datum 01-07-2015
Dob 01-07-2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	01/07/2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP – 03-03/1555/15
PËR/ZA/TO:	z. Sadri EMËRLLAHU Departamenti i Prokurimit – Ministria e Drejtësisë
CC:	z. Eset RAMA Sekretar i përgjithshëm – Ministria e Drejtësisë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Shërbimet e alarmit dhe monitorimit për Objektet e sekuestruara ose të konfiskuara”



I nderuar z. EMËRLLAHU,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin: “Shërbimet e alarmit dhe monitorimit për Objektet e sekuestruara ose të konfiskuara” me numër prokurimi: AAPSK/15/005/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik “Shërbimet e alarmit dhe monitorimit për Objektet e sekuestruara ose të konfiskuara” me numër prokurimi: AAPSK/15/005/221, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues Ministria e Drejtësisë, gjegjësisht Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, bazuar në nevojën për shërbime të alarmit dhe monitorimit të pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara, ka paraparë aktivitet prokurimi me Procedurë të Hapur. Ky aktivitet është shpallur më datë: 03/06/2015 në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë rast si rast për trajtim dhe në përputhje me misionin e saj ka konstatuar që duhet të jetë pjesë e monitorimit në këtë aktivitet prokurimi. Në sajë të sajë Agjencia ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm dhe ka njoftuar Autoritetin Kontraktues se Agjencia do të jetë pjesëmarrëse në monitorim gjatë punës së komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues e ka njoftuar Agjencinë për kohën dhe vendin e vlerësimit të ofertave dhe me këtë rast Agjencia Kundër Korrupsion ka marrë pjesë në cilësinë e monitoruesit. Pas monitorimit të procesit të vlerësimit më datë 26/06/2015, Agjencia Kundër Korrupsion ka konstatuar se procesi i vlerësimit ka qenë i rregullt dhe nuk ka mundur të konstatoj ndonjë parregullsi që mund të ndikonte në vlerësimin objektiv të ofertave. Në aktivitetin e prokurimit për shërbimet e alarmit dhe monitorimit për objektet e sekuestruara ose të konfiskuara kanë ofertuar dy Operator Ekonomik. Në fund të procesit të vlerësimit të ofertave, Agjencia Kundër Korrupsion ka konstatuar që të dy Operatorët Ekonomik ishin të përgjegjshëm.

Agjencia konstaton se Autoriteti Kontraktues duhet të vazhdoj tutje me aktivitetin në fjalë në pajtim me rregullat dhe ligjet në fuqi.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Autoriteti Kontraktuese e informon Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !